

NOCIONI, FUNKSIONI DHE SISTEMI I SANKSIONEVE PENALE

(ngritja e nivelit arsimor, kulturës dhe, vetdijes për respektimin e ligjit, të lirive , të drejtave dhe barazia e qytetarëve)

Karakteristikat themelore të sanksioneve penale--me anë të sanksioneve penale shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe të bashkësisë shoqërore,

Llojet e sanksioneve penale në përgjithësi

- dënimet kryesore
- dënimet alternative
- dënimet plotësuese
- masat siguruese,
- masat edukative,
- dënimi me kusht dhe,
- vërejtja gjyqësore.

Sistemi i sanksioneve penale në të drejtën penale të Kosovës

1.dënimet kryesore;,-*shqiptohen ndaj personave madhorë, të cilët janë penalisht të përgjegjshëm për veprën penale të kryer.*

2.dënimet alternative;,-*Këto lloje të sanksioneve penale në fakt janë një lloj i posaçëm i masave parapenale, ku kryesi i veprës penale në vend që të dënohet i tërhiqë vërejtja dhe njiherit i caktohen obligime të cilat duhet t'i përmbush brenda afatit të caktuar, e nëse nuk i përmbush obligimet e caktuara , dënimet alternative mund të revokohet dhe të shëndrrohet në dënim me burg.*

3.dënimet plotsuese ,*-janë të karakterit sekundar dhe i plotsojnë dënimet kryesore, këto dënime mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimet kryesore.*

4.vërejtja gjyqësore-*ky lloj i sanksionit është i karakterit parapenal, është e paraparë për vepra të lehta penale.*

Llojet e masave dhe sanksioneve ndaj të miturve--Ndaj kryesve të veprave penale të mitur mund të shqiptohen masat e divestetit, masat edukuese dhe burgimi për të mitur.

DËNIMET

Nocioni formal- **Përcaktohet** duke pasur parasysh elementet juridike të dënimit siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj, ligjshmëria me rastin e shqiptimit, organi i cili është kompetent për shqiptimin e tij, procedura gjyqësore që duhet të respektohet për të mundur të shqiptohet etj.

Nocioni material-Përcaktohet duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, qëllimi i dënimit është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe preventiva me qëllim që kryesi në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe të përmirësohet si dhe ruajtja e disiplinës së qytetarëve.

Sipas nocionit formalo- material.-Masë e dhunshme e paraparë me ligj, të cilën e shqipton gjyqi ndaj kryesit penalisht të përgjegjshëm të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së vlerave t'ë caktuara të qytetarve dhe të shoqërisë në tërësi

Elementet themelore të dënimit

- sipas brendisë së tij dënimi
- si masë e dhunshme
- dënimi duhet të ketë qëllimin
- dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj.

Karaktersistikat themelore të dënimit

Baza juridike e dënimit(Teoria metafizike, Teoritë mbi kontratën shoqërore, Teoritë normative, Teoritë Sociologjike)

Lidhur me këtë çështje ekzistojnë disa teori:

1.Teoria metafizike apo idealiste: sipas këtyre teorive dënimi është manifestim i hakmarrjes së shoqërisë dhe shtetit kundër kryesve të veprave penale.

2.Teoritë mbi kontratën shoqërore (grocius, Hobsi,Lloku, Bekarioetj) sipas këtyre teorive individ i ka bartë shtetit që ai t'i mbroj nga kriminalitetit, meqë vet nuk janë në gjendje të mbrohen.

3.Teoritë normativejuridike.sipas kësaj teorie baza juridike e shtetit që të zbatohet dënimet gjendet në vet sistemin juridik, në vet normën juridike mbështetet arsyeshmëria e shtetit që të aplikoj dënimet.

4.Teoritë Sociologjike, këto teori , bazën juridike të dënimit e shohin në të drejtën dhe në domosdonë e shoqërisë që të mbrohet nga kriminaliteti.

Qëllimi i dënimit(Teoria absolute, Teoria relative, Teoria e përzier)

Edhe lidhur me qëllimin e dënimit ekzistojnë disa teori:

1.Teoria absolute, sipas cilës teori qëllimi i dënimit është hakmarrja ndaj personit që kryen veprë penale

2.Teoria relative,sipas këtyre teorive qëllimi i dënimit është preventiva , që kryesi në të ardhmen mos të kryej vepra penale

3.Teoria e përzier.këto janë sintezë të teorive absolute dhe relative, sipas këtyre teorive qëllimi i dënimit nuk mund të arrihet as vetëm me hakmarrje e as vetëm me preventivë, dënimi duhet të ketë qëllim preventivën dhe hakmarrjen.

Qëllimi i dënimit sipas të drejtës penale të Kosovës,
(Duhet të jetë i drejtë. Dënimet janë legale dhe të ligjshme, dënimi duhet të jetë legjitim)

Sistemi i dënimeve në të drejtën penale të Kosovës

Ndarja e dënimeve

Kryesore dhe plotësuese (sekondare)
Dënime alternative
Dënime permanente (përjetshme) dhe
Kohore (për një kohë të kufizuar)
Dënimet kumulative dhe dënimet alternative.

DËNIMI ME VDEKJE HISTORIKU I SHKURTËR I DËNIMIT ME BURGIM E drejta jonë penale nuk e njeh dënimin me vdekje, ky dënim është abroguar më 12. dhjetor 1999 me rregulloren e UNMIKUT 1999/24

Dënimi me burgim afatgjatë
Dënimi me burgim
Në mënyrë kumulative dhe alternative
Dënimi me gjobë
Dënimet alternative

Llojet e dënimeve alternative sipas KPPK

Nocionet e dënimit me kusht dhe sistemet e ndryshme të tij

DËNIMI ME KUSHT

Kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht

-kushtet të cilat i referohen dënimit të paraparë me ligj dhe dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatës dhe,

-kushtet të cilat i referohen personalitetit të kryesit të veprës penale dhe qëllimit të dënimit me kusht

-Kushtet dhe detyrimet të cilat gjykata mund t'ia caktoj personit të dënuar me kusht (përgjithshme dhe të posaçme).

Detyrimet të cilat ia cakton gjykata të akuzuarit janë ato të cilat rezultojnë

nga disa dënime plotësuese dhe ato të parapara për disa vepra penale(212 par.3.pastaj nenit 213. pastaj nenit 293.par.4.)

***Revokimi i dënimit me kusht
Afatet e revokimit të dënimit me kusht***

***DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR TRAJTIM
TË DETYRUESHËM REHABILITUES-6m-3vjet***

***DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR MBYKQYRJE NGA
SHËRBIMI SPROVUES 6m -3 vjet***

DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme,

Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme dhe mundësia e caktimit të detyrimeve tjera,

Revokimi i dënimit me kusht me urdhër për punë në dobi të Përgjithshme.

GJYSËMLIRIA

*Kushtet për shqiptimin e gjysëmlirisë
Revokimi i gjysmë lirisë*

DËNIMET PLOTSUESE

Paraqitja dhe zhvillimi i dënimeve plotësuese,

Nocioni dhe qëllimi i dënimeve plotësuese,

Dënimet plotësuese shqiptohen krahas dënimit kryesor, kurse në disa raste krahas dënimit alternativ(dënimit me kusht),

Lidhja midis dënimeve plotësuese, dënimeve kryesore dhe alternative-karakteristikat e përbashkëta.

SISTEMI DHE LLOJI I DËNIMEV PLOTËSUESE SIPAS KPK

1.gjoha,

- 2.heqja e së drejtës për të zgjedhur,
- 3.ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik,
- 4.ndalimi i ushtrimit të profesionit, të aktivitetit ose detyrës,
- 5.ndalimi për të drejtuar automjetin,
- 6.marrja e patentëshoferit,
- 7.marrja e sendit,
- 8.urdhëri për publikimin e aktgjykimit , dhe
- 9.dënimi i të huajit nga territori i Kosovës.

MATJA E DËNIMIT

Matja ligjore e dënimit-Matja ligjore e dënimit bëhet prej organit që e nxjerrë ligji, me ç'rast ligjdhënësi cakton llojin dhe lartësinë e dënimit

Sistemi absoluti caktimit të dënimeve është sistem i atillë sipas të cilit ;ligji përcakton saktësisht llojin dhe lartësinë e dënimit që do t' i shqiptohet kryesit të veprës penale pa marr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale konkrete dhe kryesit.

*sistemi arbitrari **caktimit** të dënimit atëherë kur ligjdhënësi nuk e përcakton llojin dhe masën e dënimit , por këtë autorizim ia beson gjykatës që sipas bindjes së vet t'ia caktojëllojin dhe masën e dënimit kryesit të veprës penale. Ky sistem ka ekzistuar në sistemin e mesjetës.*

Sistemi relativ i caktimit të dënimit-ekziston atëherë kur ligji përcakton minimumin dhe maksimumin e dënimit që mund të shqiptohet për veprën

Matja gjyqësore e dënimit-Këtë lloj të dënimit e bënë gjykata kur në procedurën penale konstatohet se kryesi i veprës penale së caktuar është penalisht përgjegjës për veprën e kryer.

Matja administrative e dënimit- Krahas matjes ligjore dhe gjyqësore të dënimit ekziston edhe matja administrative e dënimit .

Ligjshmëria e shqiptimit të dënimit-Kryesit të veprës penale mund t'i shqiptohet vetëm ai dënim i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i paraparë me ligj